



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**KOMISIONERI**

Nr. 1003/1 Prot.

Tiranë, më 28.05.2026

**V E N D I M**

**Nr. 129, Datë 28.05.2026**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 228, datë 13.10.2025<sup>1</sup>, e paraqitur nga z. A.M kundër Shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi”, në të cilën pretendon diskriminimin e fëmijës së tij të mitur, O.M, për “çdo shkak tjetër<sup>2</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, dhe në dokumentacionin plotësues të dërguar me email-in datë 05.11.2025, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Në datë 09.10.2025, nga ana e mësuesit të kimisë, z. F.H, është ushtruar dhunë ndaj djalit tim O.M, nxënës i klasës së VIII-të. Për këtë ngjarje kam bërë denoncim në polici për mësuesin dhe drejtoren e shkollës. Në cilësinë e prindit të fëmijës kam marrë pjesë në Komisionin e Etikës së ngritur për këtë qëllim, duke kërkuar edhe monitorimin e procesit nga ana e ZVAP Tiranë.

Procesi administrativ disiplinor u zhvillua më datë 09.10.2025, me pjesëmarrjen e z. F.H, Koordinatorit i Cilësisë së Shkollës “Ardian Klosi”, dhe njëkohësisht edhe mësues kimie, si dhe gjithë trupa disiplinore e Komisionit të Etikës.

Me shkresën nr. 302, datë 23.10.2025, Komisioni Disiplinës më ka thirrur në seancën dëgjimore mbi procedimin disiplinor, ku jam ftuar të marr pjesë në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të fëmijës.

<sup>1</sup> Ankesa është plotësuar me dokumentacionin e dërguar nga ankuesi me email-in datë 05.11.2025.

<sup>2</sup> Për shkak të ankesës së paraqitur pranë Komisionerit me nr. 201, datë 30.09.2024, kundër shkollës dhe ZVAP Tiranë.

*Ju vë në dijeni se, u paraqita, dhe kërkoja edhe procesverbalin e mbledhjes së Komisionit të Etikës. Në prezencë të zyrtarit mbikëqyrës të ardhur nga ZVAP Tiranë, ma vunë në dispozicion aktin e kërkuar prej meje.*

*Gjatë seancës mori fjalën z. F.H, i cili mori fjalën dhe po incizonte me telefonin e tij procesin. Për këtë veprim, të befasishëm të mësuesit Z. F.H, të lejuar nga anëtarët e Komisionit të Disiplinës, ku sipas rregullores nuk lejohet që të incizohet privatisht mbledhja pa unanimitetin e gjithë pjesëtarëve të Komisionit të Disiplinës, i kërkoja mësuesit Z. F.H, që në fund të incizimit privat të bërë nga ana e tij, të më vinte edhe mua një kopje në dispozicion. Kryetarja e Komisionit (Drejtoresha e Shkollës) nuk mori asnjë masë konkrete.*

*Në këtë moment u detyrova edhe unë të veproj njësoj si mësuesi, duke nxjerrë telefonin tim personal, ku kërkoja për të incizuar mbledhjen, pasi mësues F.H më deklaronte se nuk ma jepte kopjen e incizimit që po bënte me telefonin e tij personal.*

*Në këtë moment ndërhyri edhe Kryetarja e Komisionit dhe më deklaroi se nuk lejohet të bësh incizim. Siç del qartë, diskriminimi, përveç fëmijëve, ushtrohet dhe ndaj meje publikisht.*

*Në këtë moment jam ndjerë vërtet shumë i indinjuar dhe i poshtëruar nga këto sjellje, dhe jam larguar nga mbledhja në kushtet kur u cenua standardi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkëljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte paqartësi, në lidhje me situatat e pretenduara nga ankuesi dhe lidhjes shkakësore ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, me e-mail-in, datë 24.10.2025, inspektori i çështjes, ka kërkuar nga subjekti ankues që të plotësojë ankesën me informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Subjekti ankues, me email-in datë 05.11.2025, dërgoi informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1428/1, datë 12.11.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Shkolla “Ardian Klosi”, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Me shkresat nr. 135 dhe nr. 136, datë 21.11.2025, Shkolla “Ardian Klosi”, dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash informoi se: *“Sa i takon pretendimit të z. M, kujdestari ligjor i fëmijës, se gjatë pranisë së specialistes së ZVAP, znj. K.M, Komisioni i Etikës ka vepruar “me sjellje korrekte”, ndërsa pas largimit të saj “ka rikthyer sjelljen fillestare duke mohuar garancitë konventore të procesit të rregullt ligjor përmes mosvënies në dispozicion të procesverbalit të mbledhjes”, sqarojmë sa vijon:*

*Komisioni i Etikës e ka përmbyllur mbledhjen në kohën kur përfaqësuesja e ZVAP ka qenë ende e pranishme. Për shkak të deklarimeve të gjata të të gjithë personave pjesëmarrës në ballafaqim, mbledhja është zgjatur në kohë. Sekretarja e komisionit fillimisht ka mbajtur shënime të detajuara, të cilat më pas janë hedhur në fletoren e procesverbalit. Fletët e shënimeve janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Etikës, si edhe nga përfaqësuesja e ZVAP, dhe janë bashkëlidhur procesverbalit.*

*Sa i takon pretendimit të z. M se gjatë zhvillimit të seancës së Komisionit të Disiplinës, mësuesi z. F.H ka realizuar regjistrim audio-vizual me celular “me lejen e Komisionit”, ndërkohë që vetë subjekti nuk është lejuar të kryejë regjistrim, paraqesim sqarimet si vijon:*

*Anëtarët e Komisionit të Disiplinës nuk kanë pasur dijeni paraprake për faktin se mësuesi në fjalë po kryente incizim të seancës. Në momentin kur z.M njoftoi Komisionin për ekzistencën e regjistrimit dhe kërkoi vënien në dispozicion të tij, mbledhja u ndërpre menjëherë. Kryetarja e Komisionit i kërkoi mësuesit z.F.H fshirjen e menjëhershme të incizimit në praninë e saj, veprim i cili u pasqyrua në mënyrë të detajuar në fletoren e procesverbalit.*

*Pas verifikimit të situatës dhe fshirjes së incizimit, Komisioni i Disiplinës ka vijuar veprimtarinë e tij në mënyrë të paanshme, objektive dhe në përputhje me kuadrin normativ arsimor. Në zbatim të detyrimit për referim, Komisioni ka përcjellë menjëherë pranë Komisionit të Etikës ankesën e regjistruar datë 27.10.2025, në lidhje me përdorimin e pajisjes celulare nga mësuesi, bazuar në*

*dispozitat e Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e IAP”, Kreu IX, neni 39/1, si dhe në zbatim të Rregullores së Brendshme të institucionit, neni 28/5.*

*Në këto rrethana, pretendimet e z. M për “diskriminim”, “cenim të barazisë së armëve”, apo “mungesë kontradiktorialitetit” nuk na rezultojnë të mbështetura nga të dhënat e administruara gjatë procesit. Komisioni ka ndërhyrë në momentet e nevojshme për të adresuar çdo pasaktësi procedurale dhe ka vepruar në përputhje me parimet e një procesi të rregullt administrativ, duke respektuar kuadrin ligjor dhe funksionimin e organeve kolegjiale.*

***Lidhur me masat e marra nga drejtoria e shkollës dhe shërbimi psiko-social, sqarojmë si më poshtë:***

*Pas raportimit fillestar të ngjarjes nga nxënësi pranë shërbimit psiko-social, punonjësja sociale ka vënë menjëherë në dijeni drejtorinë e shkollës. Në vijim, drejtoria, me shkresën nr. 295, datë 09.10.2025, i ka kërkuar shërbimit psiko-social ndjekjen e rastit, realizimin e takimeve individuale me nxënësin, kujdestarin ligjor dhe mësuesin, si dhe hartimin e raportit përfundimtar të vlerësimit.*

*Po në të njëjtën datë, drejtoria i është drejtuar Komisionit të Etikës dhe Sjelljes me shkresën nr. 296, datë 09.10.2025, për shqyrtimin e rastit, ndërsa me shkresën nr. 294, datë 09.10.2025, ka informuar organin epror ZVA, mbi situatën dhe hapat administrativë që do të ndërmerren.*

*Komisioni i Etikës është mbledhur me datë 10.10.2025, në prani të përfaqësueses së ZVAP, znj. K.M. Duam të theksojmë se ky komision bazuar në Rregulloren e IA-së vepron në mënyrë të pavarur dhe drejtoria e shkollës nuk merr pjesë në përbërjen e tij. Pas shqyrtimit, ky komision ka propozuar që drejtoria t'i drejtohet ZVA-së për dërgimin e një psikologu të jashtëm, me qëllim kryerjen e rivlerësimit të situatës dhe plotësimit e pyetësorëve me nxënësit, duke garantuar paanshmëri, transparencë dhe shmangie të çdo konflikti interesi, si dhe forcimin e besimit të prindërve.*

*Drejtoria, me shkresën nr. 297, datë 13.10.2025, i është drejtuar ZVA-së me kërkesën për dërgimin e një psikologu të jashtëm, kërkesë e cila është marrë në konsideratë dhe janë dërguar dy psikologe të cilat kanë zhvilluar edhe njëherë pyetësorë me nxënësit e klasave të 8-ta. Përgjigjja zyrtare me rezultatet e pyetësorëve është përcjellë nga ZVA me shkresën nr. 10254/2, datë 16.10.2025.*

*Komisioni i Disiplinës është mbledhur fillimisht me 15.10.2025, mbledhja është shtyrë me qëllim pritjen e rezultateve të ZVA-së dhe njoftimit zyrtar nga Policia e Shtetit në shkresën me nr. 299, datë 15.10.2025 me objekt “Kërkesë për informacion mbi aktin e ekspertimit mjeko ligjor”.*

*Komisioni është rimbledhur me 23.10.2025, në prani të të gjithë anëtarëve, përfaqësueses së ZVA-së, kryetares së Komisionit të Etikës, psikologut, punonjësjes sociale, mësuesi subjekt i ankesës dhe prindit/kujdestarit ligjor, i njoftuar me shkresën nr. 302, datë 23.10.2025.*

*Gjatë seancës, z. M ka kërkuar nga mësuesi z. F.H vënien në dispozicion të një regjistrimi audio-vizual ku sipas të cilit mësuesi po kryente, fakt i cili nuk ishte i njohur për Komisionin. Në vijim, z. M ka kërkuar të regjistrojë seancën, por nuk është autorizuar. Kryetarja e komisionit ka ndërprerë menjëherë mbledhjen dhe i ka kërkuar mësuesit z. F.H fshirjen e incizimit*

*në prani të saj dhe të përfaqësueses së ZVA-së, veprim i cili është dokumentuar në procesverbal. Më pas, komisioni ka vijuar procedurën dhe përmes votimit të fshehtë, ka vendosur masën disiplinore "Qortim", në zbatim të nenit 39, të Rregullores nr. 31/2020. Vendimi i është komunikuar mësuesit me shkresën nr. 303, datë 23.10.2025, si dhe prindit me shkresën nr. 120, datë 04.11.2025.*

*Me datë 27.10.2025, Kryetarja e Komisionit të Disiplinës i ka përcjellë Komisionit të Etikës, kërkesën për shqyrtimin e veprimit të mësuesit lidhur me përdorimin e pajisjes celulare gjatë mbledhjes, në kundërshtim me rregulloren e brendshme. Në vijim të kësaj kërkesë, Komisioni i Etikës është rimbledhur me 28-29.10.2025, për të shqyrtuar çështjen e përdorimit të celularit pa autorizim.*

*Pas shqyrtimit të çështjes dhe administrimit të sqarimeve të nevojshme, Komisioni i Etikës nuk ka propozuar asnjë masë disiplinore dhe e ka konsideruar çështjen të mbyllur. Si organ kolegjal, Komisioni ushtron kompetencat e tij në mënyrë të pavarur dhe vendimmarrja e tij nuk i nënshtrohet ndërhyrjes apo vlerësimit nga drejtoria e shkollës.*

*Ndërkohë, pranë DRAP Tiranë është paraqitur, me datë 29.10.2025, një kërkesë/ankesë nga z. M. Në vijim, me shkresën nr. 123, datë 07.11.2025, shkolla ka dërguar pranë inspektores së zonës, informacionin dhe sqarimet zyrtare mbi veprimet administrative të ndërmarra pas raportimit të ngjarjes, në përputhje me kërkesën e organit epror.*

### ***Lidhur me masat e marra nga psikologu i shkollës***

*Në përputhje me detyrimet funksionale të përcaktuara në kuadrin normativ të institucioneve arsimore parauniversitare, shërbimi psiko-social ka ndërmarrë këto veprime:*

- Takimi paraparak me nxënësin.*
- Është realizuar një intervistë fillestare me nxënësin, i cili ka refuzuar të vijojë komunikimin pa praninë e kujdestarit ligjor. Kjo është pasqyruar në regjistrin e punës së shërbimit psiko-social.*
- Njoftimi i mësueses kujdestare dhe kërkesa për njoftimin e kujdestarit ligjor.*
- Mësuesja kujdestare është informuar për situatën dhe është ngarkuar me detyrën e njoftimit të menjëhershëm të kujdestarit ligjor, për të garantuar vijimin e procesit me pjesëmarrjen e tij.*
- Zhvillimi i dy takimeve me nxënësit e klasës VIII-të.*
- Me datat 09.10.2025 dhe 10.10.2025, janë realizuar dy takime me grup-nxënësit e klasës, me fokus mbledhjen e informacionit objektiv lidhur me ngjarjen e raportuar dhe identifikimin e faktorëve psiko-emocionalë që mund të ndikojë te nxënësit.*
- Administrimi i pyetësorëve me nxënës të klasës VIII-të.*
- Me datë 10.10.2025, janë zhvilluar pyetësorë individualë me nxënësit, sipas formatit standard të miratuar nga ZVA, me qëllim vlerësimin e perceptimeve, ndikimit emocional dhe verifikimit të rrethanave të ngjarjes.*
- Hartimi i një raporti individual për nxënësin.*
- Psikologu sqaron se prindi/kujdestari ligjor nuk ka dhënë miratimin me shkrim për të zhvilluar konsulta individuale me fëmijën. Ditën e ngjarjes fëmija nuk ka pranuar të flasë në lidhje me ngjarjen por vetëm ka kërkuar njoftimin e prindit.*

- Përgatitja e raportit përfundimtar të rastit.
- Bazuar në të gjitha takimet dhe pyetësorët e administruar, psikologu ka përgatitur raportin përfundimtar, i cili i është vënë në dispozicion drejtuesit të institucionit dhe është bashkëngjitur dosjes administrative të rastit, i cili mban datën 13.10.2025.

### **Sqarim mbi sjelljet dhe parimet e respektuara gjatë procesit administrativ**

Në vijim të zhvillimeve të procesit administrativ, prindit/kujdestarit ligjor i është ofruar mundësia për t'u njohur me fletoren e procesverbalit, e cila mbahet dhe administrohet nga sekretarja e Komisionit. Gjatë këtij momenti, ai ka shprehur një qëndrim të karakterit personal, duke deklaruar se ka "besim të plotë se një zonjë myslimane e mbuluar nuk do të gënjente kurrë".

Ky deklaram, megjithëse artikuluar si një vlerësim individual, konsiderohet i papërshtatshëm në një procedurë administrative, pasi shtron supozime mbi bazë të përkatësive personale dhe mund të krijojë dallime të padrejta midis pjesëmarrësve në proces".

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesi nëpërmjet e-mail-it datë 02.12.2025, është njohur me përgjigjen e shkollës.

- Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, si dhe nenin 40, të Rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)<sup>3</sup>", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kishte vendosur të realizojë një seancë dëgjimore mes palëve, me datë 29.01.2026. Me email-in datë 27.01.2026, ankuesi ka kërkuar shtyrjen e seancës dëgjimore për arsye të planifikimit të një vizite mjekësore. Me shkresën nr. 295, datë 05.02.2026, Komisioneri ka njoftuar palët për shtyrjen e seancës dëgjimore për tu zhvilluar në datë 16.02.2026, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palëve në proces: ankuesi z. A.M, dhe Drejtoresha e shkollës "Ardian Klosi", znj. J.I dhe Kryetarja e Komisionit të Etikës të shkollës znj. F.P.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në dhe në mes të tjerash deklaroi se: "Djali im O.M është diskriminuar sepse është dhunuar nga mësuesi F.H dhe shkolla nuk ndërmori hapat ligjorë, por duhet të më prisnin mua për të bërë denoncimin për rastin e ndodhur. Kur e pyeta drejtoreshën dhe nëndrejtoreshën për këtë rast, ato më thanë na e bëj me shkrim sepse do komunikojmë vetëm me shkrim. Pastaj i bëra denoncim drejtoreshës për indiferencë, shpërdorim detyre, neglizhencë, etj. Shkolla vëzhgon vetëm fëmijët e mijë. Shkolla (Komisioni i Etikës) nuk më ka dhënë

<sup>3</sup> <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/RREGULLORE-KMD.pdf>

*procesverbalin atë ditë por ma kanë dhënë më vonë, kur është bërë takimi i Komisionit të Disiplinës dhe atë ditë e kam firmosur”.*

Gjatë seancës dëgjimore, drejtuesja e shkollës “Ardian Klosi”, dhe Kryetarja e Komisionit të Etikës, i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, ndërkohë që në mes të tjerash deklaruan<sup>4</sup> se: *“Ditën e ngjarjes në datë 09.10.2025, ora 09.35-40, kam qenë në mësim dhe më ka telefonuar inspektori i zonës i Komisarariatit nr. 4, i cili më ka kërkuar që të vija në dispozicion kamerat e shkollës për të bërë një investigim të një situatë që kishte ndodhur një natë më parë. Rreth orës 09.35-40, janë paraqitur dy oficerë të policisë gjyqësore, të cilët më kërkuan që të hapeshin kamerat, për të vazhduar me procedurat e tyre. Në këto momente është paraqitur punonjësja sociale A.RR, e cila më ka informuar se ka ndodhur një situatë në klasën e 8-të, mes mësuesit F.H dhe nxënësit O.M. Kam marrë informacionin dhe i kam kërkuar verbalisht punonjësës që të ndiqte të gjithë hapat në përputhje me kuadrin ligjor. Nxënësi ka ardhur në drejtori dhe ma ka bërë me dije ngjarjen dhe e kam garantuar se e gjithë situata do të ndiqet konform rregullores. Unë në ato momente kisha dy oficerët, të cilëve duhet ti jepja një përgjigje. Kam përfunduar procedurat me dy oficerët dhe menjëherë pastaj i jam drejtuar me anë të shkresës nr. 294, ZVAP-së ku e kam vënë në dijeni për të gjithë situatën e ndodhur, më pas i jam drejtuar shërbimit psiko-social të shkollës për ndjekjen e rastit, është informuar prindi dhe të gjitha këto veprime kanë ndodhur brenda një kohe prej 30 minutash.*

*Gjatë trajtimit të çështjes në Komisionin e Disiplinës, ankuesi ngriti pretendimin që i është bërë një incizim nga mësuesi F.H dhe sikur ne, kishim krijuar një terren për këtë gjë. Mësuesi ka pasur telefonin mbi tavolinë dhe unë personalisht nuk kam konstatuar asnjë lloj videoje dhe telefoni i është marrë dhe është parë nga ana jonë dhe nuk ka pasur asnjë lloj incizimi dhe video. Unë i kam bërë një shkresë Komisionit të Etikës që të marrë në shqyrtim këtë rast.*

*Znj. F.P: Mbledhja/takimi i Komisionit të Etikës u dëgjua nga të gjitha palët dhe në fund i është dhënë të gjithë personave për ta firmosur. Ankuesi nuk pranoi të firmosë pasi kërkoi të shfletonte të gjitha shënimet me radhë. Për arsye kohore i thashë se do të vëmë në dispozicion në një moment tjetër, pasi ishte ditë e premte, ora 16.30-17.00”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të nxënësit O.M, të përfaqësuar nga prindi z. A.M, nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi”**

Sipas dokumenteve të shqyrtuar, rezulton se ngjarja ka ndodhur në datë 09.10.2025, gjatë zhvillimit të orës së mësimin të kimit, ku është përfshirë mësuesi Z. F.H dhe nxënësi O.M, nxënës i klasës VIII-B. Subjekti ankuesi z. A.M pretendon se ndaj djalit të tij është ushtruar dhunë nga mësuesi. Në dokumentacionin e shkollës pasqyrohet se, sipas deklarimit të nxënësit, mësuesi e ka kapur nga krahu në një moment tensioni në klasë, ndërsa nga ana tjetër mësuesi ka deklaruar se veprimi është

<sup>4</sup> Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 30.00 e në vijim.

kryer për ta ulur nxënësin në bankë dhe për të parandaluar përshkallëzimin e situatës. Ankuesi pretendon se nga ana e shkollës nuk janë ndërmarrë hapat ligjorë për trajtimin e ngjarjes.

Rezulton se ditën e ngjarjes, Drejtoresha e shkollës me shkresën nr. 294, datë 09.10.2025, drejtuar ZVAP Tiranë, ka referuar ngjarjen, ka përmbledhur deklarinimin paraprak të nxënësit dhe ka informuar se shkolla ka mbajtur procesverbal, ka nisur ballafaqimin e palëve dhe ka përfshirë menjëherë shërbimin psiko-social. Në këtë shkresë shkolla njofton ZVA-në se do të vazhdojë mbikëqyrjen e situatës në bashkëpunim me shërbimin psiko-social të shkollës.

Me shkresën nr. 295, datë 09.10.2025, drejtoresha e shkollës i është drejtuar shërbimit psiko-social të shkollës ku i ka kërkuar që shërbimi psiko-social: - të ndjekë me prioritet rastin në mënyrë profesionale; - të realizojë takime individuale me nxënësin, kujdestarin ligjor dhe mësuesin e përfshirë; - të mbajë dokumentacion të plotë të veprimeve të ndërmarra; - dhe të hartojë një raport përfundimtar me vlerësim psikologjik e social, masat e propozuara dhe rekomandime për veprimet e mëtejshme.

Rezulton se z. A.M, pas marrjes dijeni për episodin e ndodhur ndaj djalit të tij të mitur, në datë 09.10.2025 ka bërë denoncim në Komisariatit e Policisë nr. 4, ndaj mësuesit Z. F.H dhe ndaj drejtoreshës së shkollës.

Me shkresën nr. 296, datë 09.10.2025, Drejtoresha e shkollës i është drejtuar Komisionit të Etikës të shkollës ku i ka kërkuar: - të shqyrtojë rastin në përputhje me rregulloren në fuqi; - të zhvillojë takime me palët e përfshira; - të evidentojë nëse janë cenuar normat e etikës profesionale nga ana e mësuesit; - dhe të hartojë një procesverbal dhe raport përfundimtar me konkluzione dhe rekomandime.

Nga dokumentacioni rezulton se, në zbatim të udhëzimit të drejtoreshës, shërbimi psiko-social i shkollës është angazhuar në trajtimin e rastit, dhe ka hartuar relacionin datë 09.10.2025 dhe datë 10.10.2025, në të cilin kanë evidentuar se kanë zhvilluar bisedë me nxënësit e klasës VIII-B, kanë bërë pyetje për ngjarjen dhe për të parë perceptimin e tyre mbi ngjarjen dhe mënyrën se si është zhvilluar ndërveprimi me mësuesin. Këto veprime tregojnë se shërbimi psiko-social është vënë në lëvizje si strukturë mbështetëse për vlerësimin e ndikimit emocional e social të ngjarjes dhe për administrimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet palëve.

Në datë 10.10.2025, Komisioni i Etikës ka ftuar ankuesin për të marrë pjesë në takim ku do të shqyrtohej situata e ndodhur mes mësuesit dhe nxënësit. Gjatë takimit është mbajtur procesverbal, në të cilin evidentohet se ankuesi ka vënë në dyshim paanshmërinë dhe besueshmërinë e procesit të realizuar nga shërbimi psiko-social i shkollës. Në këto kushte Komisioni ka propozuar që drejtorja e shkollës ti drejtohet ZVAP-së me kërkesë për dërgimin e një psikologe të jashtme e cila do të zhvillonte pyetësorët me nxënësit.

Me shkresën nr. 297, datë 13.10.2025, drejtorja e shkollës i është drejtuar ZVAP-së, me kërkesë për dërgimin e një psikologu të jashtëm për zhvillimin e pyetësorëve me nxënësit e klasës së 8-të. ZVAP-ja me shkresën nr. 10254/2, datë 16.10.2025, ka dërguar në shkollë rezultatet e pyetësorit të zhvilluar me nxënësit e klasës.

Referuar procesverbalit datë 13.10.2025, Komisioni i Etikës të shkollës në përfundim të shqyrtimit të rastit ka konstatuar se mësuesi F.H e ka kapur për krahu nxënësin O.M, gjë e cila bie në kundërshtim me normat e etikës së mësuesit dhe i ka propozuar Komisionit të Disiplinës masën disiplinore “Qortim” për mësuesin.

Me shkresën nr. 302, datë 23.10.2025, Komisioni i Disiplinës ka njoftuar z. A.M për të marrë pjesë në mbledhjen e atij komisioni në të cilin do të shqyrtohej ngjarja e datës 09.10.2025.

Gjatë takimit në Komisionin e Disiplinës, z. M i është vënë në dispozicion një kopje e procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Etikës. Gjatë takimit z. M ka ngritur pretendimi se mësuesi F.H po incizonte takimin.

Ky pretendim i z. M është shqyrtuar nga Komisioni i Etikës në datë 29.10.2025, i cili konkludoi se mësuesi e ka vendosur telefonin mbi tavolinë, gjatë mbledhjes së Komisionit të Disiplinës, por nuk konstatoi asnjë provë konkrete që të vërtetonte ekzistencën e një regjistrimi video/audio, nga ana e mësuesit F.H.

Komisioni i Disiplinës me shkresën nr. 303, datë 23.10.2025 ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Qortim” për mësuesin F.H, i cili me shkresë datë 27.10.2025 e ka kundërshtuar atë.

Komisioni i Disiplinës, pas shqyrtimit të kundërshtimit të masës nga ana e mësuesit, me shkresën nr. 120, datë 04.11.2025, vendosi të miratojë dhënien e masës “Qortim” ndaj mësuesit.

Në nenin 54, të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se drejtori i institucionit arsimor: “1. Drejtori drejton veprimtarinë e institucionit arsimor. 2. Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat, është përgjegjës për: a) zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij; b) ..... c)..... ç).....”.

Në nenin 62 të ligjit 69/2012, të ndryshuar, parashikohet se: “Të drejtat dhe detyrat e prindërve: 2. Prindi ka të drejtë: a) të informohet nga institucioni arsimor përkatës për legjislacionin arsimor në fuqi, për rregulloren e institucionit dhe për kurrikulën që institucioni i ofron fëmijës së tij; b) ..... c) të informohet për veprimtarinë e fëmijës së tij në institucion dhe të japë pëlqim për veprimtaritë plotësuese dhe jashtëshkollore që organizon shkolla;”.

Në zbatim të ligjit për arsimin parauniversitar, Ministria e Arsimit me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, ka miratuar “Rregulloren për Funksimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”, të ndryshuar.

Në Rregulloren e sipërcituar parashikohet si më poshtë:

“Neni 39. Veprimtaria e komisionit të etikës dhe sjelljes. 1. Komisioni trajton të gjitha ankesat që i paraqiten me shkrim brenda objektit të veprimtarisë së tij. .... 4. Komisioni shqyrton dhe gjykon në bazë të fakteve e provave të administruara në seancën dëgjimore për palën ndaj të cilës propozohet masa disiplinore. Në rastet kur vërtetohet se pala ka kryer shkelje të etikës dhe rregullores së brendshme të IA-së, përveç rasteve kur ato përbëjnë vepër penale, komisioni propozon masa sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. 5. Në rastet kur ankues

është nxënësi, komisioni ka detyrimin që në procedurën e ballafaqimit të ketë të pranishëm psikologun apo punonjës social. 6. Komisioni, në përfundim të shqyrtimit të ankesës i propozon drejtorit të IA-së masën disiplinore për çështjet e ngritura në ankesë, në përputhje me parashikimet e rregullores. Vendimmarrja i takon komisionit të disiplinës.

Neni 42; 1. Drejtori i institucionit arsimor është titullari i institucionit, që ka të drejtën e firmës dhe të vulës së institucionit. 2..... 3. Drejtori ka përgjegjësinë për zbatimin në institucionin arsimor të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi;

Neni 56; 2. Mësuesi ka për detyrë: c) të trajtojë këdo, në mjediset e IA-së, me respekt, me dinjitet, në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme, pa presione, pa padrejtësi, pa fyerje, pa diskriminim, pa dhunë;

Neni 69. Trajtimi i sjelljeve të dhunshme të mësuesit ndaj nxënësit; 1. Përdorimi i dhunës verbale, psikologjike, fizike apo seksuale nga ana e mësuesit ndaj nxënësve është i ndaluar. 2. Në rastin e konstatimit të dhunës, nxënësi, ndaj të cilit është ushtruar dhunë, ka të drejtë të ankohet te mësuesi kujdestar ose psikologu/punonjësi social i IA-së, të cilët njoftojnë drejtorin e institucionit. 3. Drejtori e paraqet rastin para komisionit të etikës dhe sjelljes. 4. Kur ky komision konstaton kryerjen e shkeljes nga ana e mësuesit, bën rekomandimin për drejtorin e IA-së për marrjen e masës disiplinore ndaj mësuesit, sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore.

Neni 101. Komisioni i disiplinës. 6. Komisioni i disiplinës në IA shqyrton rastet e konstatuara nga komisioni i etikës dhe sjelljes për shkeljet disiplinore të kryera nga ana e nxënësve, mësuesve dhe nëndrejtorëve.

Neni 107. Masat disiplinore për mësuesit dhe nëndrejtorin. 1. Komisioni i disiplinës i IA-së jep masën disiplinore për mësuesin ose nëndrejtorin, kur: a) konstaton shkelje të legjislacionit në fuqi për arsimin parauniversitar, të kësaj rregulloreje ose të rregullores së brendshme të institucionit;.... 5. Në rastet kur mësuesi/nëndrejtori ka ushtruar dhunë ndaj nxënësve ose punonjësve të institucionit, dhe këto veprime janë të provuara, jepet masë disiplinore “largim nga detyra”, përveç veprimeve të tjera që mund të ndiqen nga strukturat kompetente sipas legjislacionit në fuqi”.

Në nenin 29 të Rregullores për Funkcionimin e IAP-ve të ndryshuar, parashikohet funksionimi i shërbimit psiko-social në institucionet arsimore, në të cilën përcaktohet se: “2. Shërbimi psiko-social u ofrohet: a) nxënësve të IA publike. .... b) ..... c) Shërbimi psiko-social mbështet personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve dhe bashkëpunon me ta për zgjidhjen e situatave dhe në raste nevojë të kërkuara prej tyre”.

Shërbimi psiko-social në institucionin arsimor përbëhet nga punonjësi social dhe psikologu. Të dy këto punonjës të institucionit arsimor, përveç dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë arsimin parauniversitar, i nënshtrohen legjislacioneve respektive<sup>5</sup> që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së profesionit të punonjës social dhe psikologut.

<sup>5</sup> Kodi i Etikës dhe Deontologjisë të Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë.

Kodi i Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 31/7, të Urdhrit nr. 31/2020, të MAS, përcaktohet shprehimisht se: *“Psikologu/punonjësi social ka këto detyra kryesore në institucionin arsimor: .....7. Raporton me shkrim për çdo rast të provuar apo të dyshuar për abuzim të nxënësve nga punonjës arsimor dhe nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit të drejtuesi i NjShPS dhe te drejtori i IA-së”*.

Bazuar në legjislacionin e sipërcituar, nga shqyrtimi i tërësisë së akteve të administruara rezulton se menjëherë pas ndodhjes së ngjarjes së datës 09.10.2025, rasti është ndjekur përmes një vargu veprimesh të njëpasnjëshme, të cilat përfshijnë: - evidentimin e rastit nga drejtorja e shkollës; - mbajtjen e procesverbalit; - organizimin e ballafaqimit të palëve; - referimin dhe aktivizimin e shërbimit psiko-social; - vënien në dijeni të ZVAP Tiranë; - shqyrtimin nga Komisioni i Etikës; - kalimin e çështjes për procedim pranë Komisionit të Disiplinës.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se drejtorja e shkollës po atë ditë i ka kërkuar shërbimit psiko-social të shkollës që të ndjekë të gjithë hapat e parashikuar nga legjislacioni i sipërcituar për të shqyrtuar rastin.

Aktet e hartuara nga shërbimi psiko-social i institucionit arsimor, janë të plotë dhe përshkruajnë me detaje veprimet e kryera nga ata si: - takimi paraprak me nxënësin O.M; - njoftimin e prindit të nxënësit; - takimi në prani të prindit, nxënësit, psikologut, punonjësës sociale, mësueses kujdestare dhe mësuesit F.H; - dy takime të zhvilluara me nxënësit e klasës; - zhvillimi i pyetësorëve me nxënësit dhe dokumentimin e të gjitha veprimeve të kryera. Në përfundim, shërbimi psiko-social në referim të pyetësorëve të zhvilluar ka evidentuar se asnjë nxënës nuk e ka përmendur mësuesin e kimisë F.H sit ë përfshirë në një situatë dhune.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar dhe legjislacionit sipërcituar, rezulton se shkolla “Ardian Klosi”, ka shqyrtuar ngjarjen e ndodhur të raportuar nga nxënësi, bazuar në parashikimet e Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020, Rregullore për Funksonimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare, të ndryshuar.

Referuar procesverbaleve të psikologut të shkollës, të Komisionit të Etikës dhe Komisionit të Disiplinës, rezulton se këto komisione pasi kanë shqyrtuar provat dhe faktet në dispozicion, kanë dëgjuar nxënësit e klasës, mësuesit e shkollës, nxënësin O.M, mësuesin F.H, dhe nuk kanë konstatuar elementë të mirëfilltë të dhunës ndaj nxënësit dhe kanë propozuar masë disiplinore, qortim për mësuesin.

Në rastin objekt shqyrtimi, rezulton se prindi i nxënësit është njoftuar nga shkolla, për mbledhjet e të dy komisioneve, si të Komisionit të Etikës dhe të Komisionit të Disiplinës, në të cilat i është ofruar mundësia për tu dëgjuar dhe për të dhënë opinionin e tij.

Gjatë shqyrtimit të ngjarjes të datës 09.10.2025, psikologu i shkollës, Komisioni i Etikës dhe Komisioni i Disiplinës, kanë arritur në përfundimin se ka pasur shkelje të etikës nga ana e mësuesit F.H, por kjo shkelje nuk ka qenë të një masë të tillë, sa të konsiderohej si përdorim dhune dhe kanë propozuar masë disiplinore në proporcion me gjetjen e konstatuar/provuar.

Në rastin objekt shqyrtimi, Komisioni i Etikës dhe Komisioni i Disiplinës së shkollës “Ardian Klosi”, nuk kanë arritur të provojnë se ndaj nxënësit O.M të jetë ushtruar dhunë, sipas parashikimeve të nenit 107, pika 5, të Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare, dhe për këtë arsye masa disiplinore e marrë për mësuesin, është sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin parauniversitar.

Në pikat 2 dhe 4, të nenit 102 të Urdhrit nr. 31/2020, të MAS, të ndryshuar përcaktohet se: “2. *Masat e përshkallëzuara që Komisioni i Disiplinës vendos për mësues ose nëndrejtorin, varësi të llojit të shkeljes apo përsëritjes së të njëjtës shkelje janë: “a) qortim; b) vërejtje; c) paralajmërim për largim nga puna; ç) largim nga puna.....”.*

Komisioneri vlerëson se, masa disiplinore e dhënë ndaj mësuesit F.H “Qortim” është proporcionale në raport me shkeljen e konstatuar. Kjo masë disiplinore është gjithashtu në linjë me parimin e përshkallëzimit të parashikuar nga neni 107/2 të urdhrit 31/2020, të ndryshuar, lidhur me dhënien e masave disiplinore nga ana e Komisionit të Disiplinës. Bazuar në rrethanat e çështjes, kur ndaj ankuesit nuk ka pasur masë disiplinore të mëparshme në fuqi, si dhe duke mbajtur parasysh shkeljen që pretendohet se është kryer nga mësuesi F.H, dhënia e masës disiplinore “Qortim” është në proporcion me shkeljen e konstatuar.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, shkolla “Ardian Klosi” ka zbatuar legjislacionin e sipërcituar, i detyrueshëm për institucionet arsimore, duke shqyrtuar dhe trajtuar rastin sipas fakteve dhe provave të grumbulluara nga palët, nëpërmjet psikologut të shkollës, punonjësës sociale të shkollës, Komisionit të Etikës dhe Komisionit të Disiplinës dhe se nxënësi O.M, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e shkollës “Ardian Klosi”.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Nga ana e Shkollës “Ardian Klosi”, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe hapat, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, si: - pyetja e palëve kryesore; - marrja e deklarimeve nga nxënësit e klasës; - administrimi i vlerësimit të psikologut të shkollës dhe ZVAP-së; - ballafaqimi i palëve; - dhe marrja e vendimit bazuar në prova dhe fakte.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se Shkolla 9-vjeçare “Ardian Klosi”, ka zbatuar legjislacionin e sipërcituar, i detyrueshëm për institucionet arsimore dhe se nuk ka ndërmarrë veprime që kanë ekspozuar fëmijën e subjektit ankues ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme nga ana e këtij institucioni, për shkakun e pretenduar nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Shkolla “Ardian Klosi”, Tiranë, ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të nxënësit O.M, të përfaqësuar nga prindi A.M, nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi”, Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Genta TAFA (Bungo)**